**STANDARTE DHE PROCEDURA QE DUHEN NDJEKUR PER TE BERE KERKESE PER INFORMIM DHE ANKESES**

## Standartet dhe procedurat për të bërë kërkesë për informim

Kërkesa për informim bëhet me shkrim dhe dërgohet dorazi pranë Bashkisë Mallakastwr, me postë në adresën: Bashkia Mallakastwr, Lagja ‘’18 Prilli ”, me postë elektronike në adresën: info@bashkiamallakaster.gov.al ose me anë të portalit “Pyetshtetin.al**” .**

*Kërkesa për informim duhet të përmbajë:*

a) emrin dhe mbiemrin e kërkuesit;

b) adresën postare ose elektronike ku kërkohet të dërgohet informacioni;

c) përshkrimin e informacionit që kërkohet;

ç) formatin në të cilin preferohet informacioni;

d) çdo të dhënë që kërkuesi gjykon se mund të ndihmojë në identifikimin e informacionit të kërkuar;

Afati për marrjen e informacionit, është jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e dorëzimit të kërkesës.

Kur kërkesa për informacion, i dërgohet një autoriteti tjetër publik, afati për marrjen e përgjigjes është jo më vonës se 15 ditë pune nga dita e mbërritjes së kërkesës në autoritetin e parë.

Afati mund të zgjatet me jo më shumë se 5 ditë pune për një nga shkaqet e mëposhtme:

a) nevoja për të kërkuar dhe shqyrtuar dokumente të shumta e voluminoze;

b) nevoja për t’i shtrirë kërkimet në zyra dhe mjedise që janë fizikisht të ndara nga zyra qendrore e autoritetit;

c) nevoja për t’u konsultuar me autoritete të tjera publike përpara marrjes së një vendimi për plotësimin ose jo të kërkesës.

Vendimi për zgjatjen e afatit i njoftohet menjëherë kërkuesit.

Formular kwrkese pwr informim

## KËRKESE PËR INFORMACION

| | | |
|---|---|---|
| **Emër Mbiemër:**<br>Z./Znj. ______________________ | **Adresa postare:** ______________________<br>**Adresa elektronike:** ______________________<br>**Nr. Tel:** ______________________ | Data: __/__/_____<br>Nënshkrimi: |

*(dërgimi i kërkesës elektronikisht kërkon emër, mbiemër, nënshkrim dhe dokument identifikimi të skanuar)*

| **Përshkrim i detajuar i informacionit të kërkuar** |
|---|
| ________________________________________________ |
| ________________________________________________ |
| ________________________________________________ |
| ________________________________________________ |
| ________________________________________________ |
| ________________________________________________ |
| ________________________________________________ |

| **Të tjera të dhëna** |
|---|
| ________________________________________________ |
| ________________________________________________ |

**Forma që kërkohet informacioni / dokumentacioni:** ________________________________________
________________________________________________

| **Vetëm për përdorim zyrtar** | | |
|---|---|---|
| Data e marrjes: __/__/201_ | Numri rendor i kërkesës: | Komente: __________________<br>__________________<br>__________________ |

Informacioni në këtë format dhe të dhënat e ID do të përpunohen në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".

- Adresa dhe kontaktet mund të gjenden nëpërmjet konsultimit pa pagesë të informacionit në mjediset e autoritetit publik, nëpërmjet portalit unik qeveritar e-albania.al apo, kur është rasti, nëpërmjet faqes zyrtare të autoritetit publik në internet.
- Drejtoni kërkesën tuaj, Koordinatorit për të drejtën e informimit, të institucionit që mban informacionin e kërkuar. Kontaktet e tij, janë të publikuara në faqen zyrtare të institucionit.
- Kur ju mendoni se ju kanë mohuar ndonjë prej të drejtave tuaja në bazë ligjit, keni të drejtë të ankoheni tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.